

## FTESË PËR OFERTË

### Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

|                    |   |
|--------------------|---|
| Emri               | Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor |
| Adresa             | Rr. Muhedin Llagani, Nr. 10 Tiranë.                         |
| Tel/Fax            | 0355 688015833  |
| E-mail             | dpshttr@dpshttr.gov.al                                      |
| Faqja e Internetit | <a href="http://www.dpshttr.gov.al">www.dpshttr.gov.al</a>  |

### OBJEKTI:

### **PËR BLERJEN E NJË TRUALLI JO MË PAK SE 5000 (PESË MIJË) M2 DHE SIPËRFAQE GODINE E VENDOSUR NË KËTË TRUALL RRETH 1000 M2.**

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor njofton të interesuarit/ofertuesit se kërkon të bleje truall dhe godine për ushtrimin e veprimtarisë së administrates së Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Berat, duke u bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Të jetë objekt ndërtimor (godinë) me sipërfaqe rreth 1000 m<sup>2</sup>, e domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit .
- Sipërfaqe truall jo më pak se 5000 m<sup>2</sup>.
- Objekti të jetë i hipotekuar (dokumentacioni vërtetues certifikatë/vertetim pronësie, kartelet dhe hartet treguese të jetë i tre muajve të fundit) dhe të ketë një gen – plan, ku përcakton vendndodhjen dhe sipërfaqen e ambientit të ofruar si dhe planimetrinë të hartuar nga një inxhinier/subjekt i licensuar.
- Vërtetim nga autoriteti përkatës për regjistrimin e pasurisë së palujtshme, për statusin juridik të sipërfaqes së tokës dhe objektit (godinës).
- Deklaratën noteriale nga pronari i pasurisë së palujtshme që nuk ka konflikt me palë të treta dhe që prona është e lire.
- Deklaratë noteriale nga pronari i pasurisë së palujtshme, se ka shlyer të gjitha detyrimet për pagesën e taksës së përdorimit të truallit dhe objektit (godinës ), deri në Qershor 2019, bazuar në ligjin Nr. 9632, datë 30/10/2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.
- Prona të jetë e pozicionuar në vend të favorshëm për kryerjen e aktivitetit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Berat, ku kusht kryesor është komunikimi i tyre me rrugë ku të lëvizin lirshëm makineri të tonazhit të rëndë.
- Prona të jetë e rrethuar dhe me kufi të dallueshëm sipas certifikatës së pronësisë.



- Prona të ketë lehtësi të lidhjes me rrjetet inxhinierike të jashtme (lidhja me energji elektrike, ujësjellës, kanalizime, telefonine, internet, etj).

## **2. Ofertat që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përbëhet nga dokumentacioni i mëposhtëm:**

- Kërkesa e subjektit për pjesëmarrje në konkurrim;
- Oferta e ofertuesve me cmim për m<sup>2</sup> truall dhe m<sup>2</sup> ndërtesë
- Dokumentacioni vërtetues, (certifikatë/vertetim pronësie, kartelet dhe hartë treguese të jetë i tre muajve të fundit) .
- Gen-plan, ku përcakton vend-ndodhjen dhe sipërfaqen e ambientit të ofruar si dhe planimetrinë të hartuar nga një inxhinier/subjekt i licensuar;
- Komisioni i negocimit rezervon të drejtën për verifikimin në vend të godinës me kriteret e kërkuara para marrjes së një vendimi përfundimtar.
- Cmimi maksimal i tokës truall, ( sipërfaqe tokë jo bujqësore) në zonën kadastrale mundësisht brenda unazës së qytetit të Beratit, me të cilin do të negociohet është 4183 lekë / m<sup>2</sup>
- Cmimi maksimal i godinës në zonën kadastrale mundësisht brenda unazës së qytetit të Beratit, me të cilin do të negociohet është 41400 lekë /m<sup>2</sup>

Ky dokumentacion të paraqitet në një zarf, të mbyllur, nënshkruar nga ofertuesi, me mbishkrimin “Ofertë për truall dhe godinë” dhe i dorëzohet Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor Tiranë, në datën dhe orën e hapjes së konkurimit. Në ofertën e tij, ofertuesit duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit të kontaktit.

Dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje e noterizuar.

### **Mosparaqitja e njërës prej dokumentave të mësipërme, përbën kusht skualifikues.**

Vendi i zhvillimit të konkurimit: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor , zyra e protokollit, me adresë: Adresa: “Rr. “Muhedin Llagani” Nr.10”, Tiranë; Tel.: +355 69 801 5 833 Fax.: +355 (0) 4 2238175;

Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët, fizikisht, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.

Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese do të jetë data : 01/08/2019 ora 12:00

